



Planuar / Dorezuar Primiçeno/Prodato Received/Delivery	09.10.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Ish Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMSTICK	5887/2022		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.720/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi -anëtarë, si dhe Çlirim Zeka - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.720/2022 të datës 22.08.2022 të parashtruar nga ankuesja indër Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës , në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.720/2022 e datës 22.08.2022 e parashtruar nga ankuesja.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën “Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa” përmes e-mailit më datë 19.08.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës e cila në Këshill është protokolluar me numër 4836/2022 me datë 22.08.2022, kundër mos aprovimit të pushimit vjetor nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.08.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës. Më datë 12.09.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokollit 4836/2022 të datës 22.08.2022 të parashtruar nga ankuesja në



Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga K.M. për ankesa.kpmshck@rks-gov.net i datës 19.08.2022; Kërkesa për pushim e K.M. e datës 24.12.2021; Kërkesa për pushim e K.M. e datës 20.06.2022; Kërkesa për pushim e K.M. e datës 24.05.2022; E-mail nga K.M. për B.Z. i datës 08.08.2022; E-mail nga K.M. për B.Z. i datës 12.02.2021; Vendim me numër 01 Nr.500/10 i datës 20.09.2010; E-mail nga K.M. për B.Z. i datës 20.01.2021; Vendim i datës 09.07.2020; Vendim me nr. 01/122/20 i datës 29.06.2022; Kërkesa për pushim e K.M. e datës 11.08.2022; Vendim me nr. 01/43/20 i datës 27.02.2020; Deklaratë e datës 15.06.2020; Dëftesa me nr. 004529; E-mail nga N.X. për K.M. i datës 06.07.2020; E-mail nga K.M. për B.Z. i datës 07.07.2020; E-mail nga B.Z. për K.M. i datës 09.07.2020; E-mail nga K.M. për F.H. i datës 08.07.2020; E-mail nga F.H. për K.M. i datës 08.07.2020; E-mail nga V.F për F.H. i datës 08.07.2020; E-mail nga K.M. për V.F. i datës 08.07.2020; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 28.02.2019; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 09.06.2020; Ankesë për Komisionin e Ankesave në ASHAK e datës 08.07.2020; E-mail nga K.M. për S.B. i datës 12.10.2020; E-mail nga D.R. për K.M. i datës 04.08.2020; Vendim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës i datës 21.07.2020; E-mail nga K.M. për B.Z. i datës 09.07.2020; Shkresë e datës 09.07.2020; E-mail nga K.M. për V.D. etj. i datës 09.07.2020; E-mail nga I.M. për K.M. i datës 12.11.2021; E-mail nga B.Z. për I.M. i datës 05.11.2021; Vendim i datës 15.05.2015; Dëftesë e datës 19.07.2020; E-mail nga K.M. për B.Z. i datës 08.07.2020; E-mail nga F.H. për K.M. i datës 08.07.2020; E-mail nga V.F. për F.H. i datës 08.07.2020; E-mail nga K.M. për V.F. i datës 08.07.2020; E-mail nga K.M. për B.Z. i datës 07.07.2020; Akt Emërimi me nr.08 i K.M. i datës 01.08.2011; Kontrata e Marrëdhënies së Punës me nr.980 e K.M. i datës 20.09.2010; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 09.06.2020; Kërkesa për pushim e K.M. pa datë; Vendim me numër 01 Nr.500/10 i datës 20.09.2010; E-mail nga K.M. për B.Z. i datës 18.08.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 31.08.2022; Përgjigje në ankesë e datës 12.09.2022; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 15.04.2011; Përshkrimi i Detyrave të Punës; Kërkesa për pushim e K.M. e datës 11.08.2022; E-mail nga K.M. për B.Z. i datës 08.08.2022; Vendim i KPMSCHK me nr. protokolli 2959 i datës 20.05.2022; Organogrami i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës; Kërkesa për pushim e K.M. e datës 14.07.2017; Kërkesa për pushim e K.M. e datës 02.05.2018; Kërkesa për pushim e K.M. e datës 28.07.2019; Kërkesa për pushim e K.M. e datës 16.12.2020; Kërkesa për pushim e K.M. e datës 20.06.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i K.M. i datës 30.12.2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i K.M. i datës 30.12.2019; E-mail nga K.M. për ankesa.kpmshck@rks-gov.net i datës 29.08.2022; Lista e pagave e datës 01.03.2022 deri 31.03.2022; E-mail nga C.Z. për D.D. i datës 28.09.2022; E-mail nga D.D. për C.Z. i datës 29.09.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka parashtruar ankesë kundër mos aprovimit të pushimit vjetor nga Kryeshefi Ekzekutiv në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se bazuar në shkresat e lëndës ankuesja është e punësuar në pozitën "Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa" sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2011 në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, Departamenti për Administratë dhe Financa. Ndërsa e njëjta është caktuar nga Kryeshefi i



Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës sipas Vendimit me 01.Nr.500/10 të datës 20.09.2010 përveç pozitës si "Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa" kryen edhe punë dhe detyra të punës si "Zyrtare Kryesore Financiare".

Ankuesja me datë 08.08.2022 përmes e-mailit e ka njoftuar Kryeshefin e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës se nga data 15.08.2022 deri me datë 26.08.2022 do të jetë në pushim vjetor dhe se në punë do të kthehet me datë 29.08.2022. E njëjta me datë 11.08.2022 e ka bërë kërkesën për pushim vjetor si ZKF tek Kryeshefi i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës nga data 15.08.2022 deri me datë 26.08.2022.

Kryeshefi i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës me datë 11.08.2022 ankuseses i ka refuzuar kërkesën për pushim me arsyetimin se zyrtarja nuk e ka dhënë pozitën e saktë të punëve që i kryen, si detyrë parësore dhe që ekziston në Organogramin që është në fuqi, po ashtu ai potencon se Znj. Mashmuti është "Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa" dhe kështu e ka bërë edhe ankesën kundër vlerësimit të rezultateve të punës në KPMSCHK dhe për epror e ka Drejtorin e Departamentit për Administratë dhe Financa, prandaj kërkesa duhet të drejtohet Drejtorit të DAF-it"

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në Akt Emërimin e ankuseses të datës 01.08.2011 e cila mbanë pozitën "Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa" si dhe duke u bazuar në Përshkrimin e Detyrave të Punës të datës 15.04.2011, ka konstatuar se ankuesja në bazë të Akt Emërimit të lartcekur i raporton Drejtorit të Departamentit për Administratë dhe Financa. Po ashtu duke u bazuar në Organogramin e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës kolegji ka konstatuar se pozita "Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa" është nën Departamentin e Administratës dhe Financave dhe rrjedhimisht ankuesja si detyrë parësore e ka pozitën të cilën e mbanë sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2011.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se duke u bazuar në dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, gjegjësisht nenin 1 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, është përcaktuar se: "1. Kjo Rregullore përcakton rregullat për: 1.2. pushimet dhe procedurat për shfrytëzimin e pushimeve", ndërsa më nenin 9 paragrafi 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje, është përcaktuar se: "1. Zyrtari publik për çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej njëzet (20) ditëve. 2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni zgjatja e pushimit vjetor përcaktohet varësisht nga stazhi i punës, ku për çdo pesë (5) vite të përvojës së punës, shtohet një (1) ditë punë", kurse me nenin me nenin 10 paragrafi 2 dhe 3, të kësaj rregulloreje, përcaktohet se: "2. Çdo mbikëqyrës i drejtpërdrejtë harton dhe përcjell njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore, brenda muajit Janar, planin orientues të shfrytëzimit të pushimeve vjetore prej zyrtarëve publikë në varësi, në përputhje me kërkesat e këtyre zyrtarëve dhe nevojat e institucionit. 3. Kërkesa për shfrytëzimin e pushimit vjetor dorëzohet së paku dy (2) ditë punë nga zyrtari publik tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë përveç pushimeve me më pak se pesë (5) ditë, ku kërkesa paraqitet dhe miratohet brenda ditës", mbi baze të këtyre dispozitave ligjore të lartpërmendura është e rregulluar çështja e miratimit të pushimit vjetor dhe në rastin konkret meqenëse ankuesja si pozitë të përhershme sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2011 e mban pozitën "Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa", dhe në bazë të përshkrimit të detyrave të punës raporton tek Drejtori i Departamentit për Administratë dhe Financa, rrjedhimisht e njëjta edhe kërkesën për pushim është dashur që ta paraqes tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejt e jo tek Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të




Kosovës, andaj Kolegji i Këshillit duke u bazuar ne dëshmitë e ofruara gjegjësisht lidhur me refuzimin e kërkesës për pushim vjetor nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv konstaton se i njëjti me rastin e refuzimit të kësaj kërkesë ka vepruar në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë dhe se pretendimi ankimor i ankueses është i pabazuar, sepse pushimin vjetor e miraton mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.720/2022

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.